




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	27.06.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Zëvendësimi i tarifave fikse mujore aktuale me dy nivele me tarifa të bazuara në madhësinë e lidhjes

Të nderuar,

Konsultimi publik i 24 janarit 2024 përfshinte një propozim për tarifat fikse mujore aktuale prej 1,00 EUR në muaj për konsumatorëve shtëpiak të ujit dhe 2.00 EUR në muaj për lidhjet/ kyçjet e konsumatorëve jo-shtëpiak dhe zëvendësimin me tarifa fikse mujore të bazuara në madhësinë/ diametrin e lidhjes/ kyçjes pavarësisht nëse konsumatori është shtëpiak apo jo-shtëpiak. Arsyeimi i ARRU-së nuk është kosto-reflektive dhe mund të konsiderohet si e padrejtë, veçanërisht për konsumatorët e vegjël jo-shtëpiak, tek të cilët diametri i gypit të kyçjes dhe konsumi janë të njëjtë sikur tek konsumatorët shtëpiak. Ky propozim përgjithësisht u mbështet nga të anketuarit.

Në shtojcën A të kësaj shkrese është prezantuar propozimi i ARRU-së për lartësinë e taksës fikse mujore të bazuar në diametrin e kyçjes/ lidhjes. ARRU kërkon që KRU-të të rishikojnë sugjerimin rreth lartësisë së taksës së propozuar dhe të na informoni për ndonjë propozim tjetër alternativ. Ju lutem të të ofroni evidencë rreth propozimeve tuaja.

Në përputhje me metodologjinë e përcaktimit të tarifave të ardhurat totale të pritshme nga këto tarifa fikse mujore do të zbriten nga kërkesa për të ardhura me bilancin e përdorur për të përcaktuar tarifën volumetrike. Kjo nuk do të rezultojë në rritje neto të të ardhurave siç do të ishte sipas tarifave fikse mujore të mëparshme. Parashikimi i ARRU-së është se shumica e lidhjeve të konsumatorëve shtëpiak dhe bizneset e vegjël do të jenë 15mm ose 20mm dhe do të jenë subjekt i tarifave fikse mujore më të ulta. Edhe pse tarifat fikse mujore për të gjithë konsumatorët do të rriten për të qenë më kosto reflektive, janë konsumatorët më të mëdhenj jo-shtëpiak që do të kenë tarifa fikse mujore dukshëm më të larta për të pasqyruar kostot dukshëm më të larta të lidhura me zëvendësimin periodik të matësit.

Edhe pse tarifat fikse mujore për konsumatorët shtëpiak do të rriten, efekti neto do të rezultojë me tarifa volumetrike më të ulëta. Hulumtimi ynë na tregon se konsumatorët në me kushte më të rënda financiare në Kosovë janë familjet më të mëdha që në mënyrë të pashmangshme përdorin më shumë ujë se mesatarja. Këto familje kanë më shumë gjasa të përfitojnë nga tarifat fikse mujore më të larta dhe tarifat e volumetrike më të ulëta se çfarë do të ishin ndryshe.

Prandaj ju japim njoftim zyrtar se me efekt nga 1 janari 2026, plani tarifor nuk do të përfshijë më tarifatat fikse mujore me dy nivele (shtëpiake dhe jo shtëpiake). Tarifatat fikse mujore për ciklin tarifor 2026-2028 do të bazohen më pas në madhësinë e lidhjes. ARRU do të kërkojë gjithashtu që tarifatat fikse mujore të rregullohen çdo vit me inflacionin në përputhje me tarifatat volumetrike pasi kjo do të përmirësojë parimin e kosto-reflektivitetit. Modeli tarifor do të rregullohet për t'u përshtatur me këto ndryshime.

ARRU kërkon nga KRU-të t'i rezistojnë çdo kërkesë të konsumatorëve për lidhje/ kycje me diametër më të vogël, nëse ka gjasa të shkelë ndonjë rregullore ndërtimi në lidhje me sigurinë (zjarrfikësit në veçanti).

Nga tani e deri në fillim të vitit 2025, në kohën fillohet me përgatitjet për aplikacion tarifor 2026-2028, KRU-të duhet të mbledhin të dhënat e konsumatorëve lidhur me numrin e lidhjeve (ekzistuese dhe të planifikuara) dhe diametrimin e tyre.

Nga tani deri më 1 janar 2026, KRU-të duhet të përshtatin sistemet e tyre të faturimit për të akomoduar këto tarifa të propozuara.

Ne kërkojmë që ju të na mbani të informuar mbi progresin në lidhje me grumbullimin e të dhënave dhe ndryshimet në sistemet tuaja të faturimit.

Me respekt,

Shtojca A – Përcaktimi i tarifave fikse mujore

Që nga konsultimi ne kemi shikuar koston e zëvendësimit të ujëmatësit më hollësisht dhe vlerësimi ynë i rishikuar i tarifave fikse mujore në këtë letër është se tarifat janë më të larta se mendimet tona fillestare siç është përcaktuar në dokumentin e konsultimit. Kjo është kryesisht për shkak të asaj që ne tani e konsiderojmë se kemi nënvlerësuar koston e instalimit, të leximit dhe faturimit të ujëmatësve.

Tarifat janë përcaktuar bazuar në koston e blerjes së ujëmatësit, instalimit, plus materialin shtesë dhe për punë fizike. Kjo kosto shpërndahet përgjatë jetëgjatësisë së ujëmatësit (5 vjet) për të përcaktuar një tarifë vjetore. Tabela 1 sugjeron nivelin e tarifave bazuar në koston aktuale të ujëmatësve (çmimet e vitit 2024). Këto kosto do të rregullohen për nivelin e çmimeve të vitit 2025 për përfshirje në planet e biznesit për vitin 2026-2028.

Tabela 1 – Vlerësimi i ARRU-së për tarifat fikse mujore (nivelet e çmimeve të vitit 2024)

(1) Madhësia e metrit (mm)	(2) Furnizimi dhe instalimi i matësit (EUR), përfshirë pjesët e fazonike të domosdoshme për instalim të UM.	(3) Tarifa vjetore e anuitizuar (EUR)	Tarifa mujore e sugjeruar (EUR) Opsioni A	Tarifa mujore e sugjeruar sipas grupit (EUR) Opsioni B
15	70 €	14.0	1.2	1.25
20	80 €	16.0	1.3	
25	100 €	20.0	1.7	2.0
32	140 €	28.0	2.3	
40	220 €	44.0	3.7	8.1
50	750 €	150.0	12.5	
65	1,150 €	230.0	19.2	20.0
80	1,250 €	250.0	20.8	
100	1,400 €	280.0	23.3	24.6
125	1,550 €	310.0	25.8	
150	1,960 €	392.0	32.7	38.8
200	2,700 €	540.0	45.0	
250	3,250 €	650.0	54.2	54
>250	Të përcaktohen nga KRU-të			

Për konsumatorët që marrin vetëm shërbimet e ujërave të ndotur propozohet tarifa fikse të ketë vlerën e 50% të tarifës fikse të konsumatorëve që kanë diametër të lidhjes 15 dhe 20 mm (të dhënë në tabelën 1).

Për t'i vënë këto tarifa në perspektivë ne kemi shqyrtuar tarifat fikse mujore që zbatohen në vende të tjera që janë projektuar gjithashtu për të përmbushur koston e leximit të ujëmatësit, faturimit, dhe riparimit / zëvendësimit të ujëmatësve. Në disa vende, tarifat fikse mujore janë shumë më të larta se opsioni i mësipërm

me tarifa fikse mujore vjetore (me diametër të vogël) për ujin dhe ujërat e ndotura, më të mëdha se 100 EUR në vit.

Llogaritjet e mësipërme ofrojnë dy mundësi. Opsioni A lejon tarifa individuale për 13 madhësi të ndryshme të lidhjeve. Opsioni B redukton numrin e tarifave të ndryshme në 7 grupe të madhësisë / diamterit të lidhjes. KRU-të duhet të vendosin cilin opsion e aprovojnë, apo të propozojnë ndonjë opsion tjetër, i cili në fund do të aprovohet si propozim i unifikuar për të gjitha KRU-të. Qëndrimi ynë është se duhet të jemi të kënaqur që tarifat demonstrojnë pasqyrimin e përmirësuar të kostos- reflektive i cili mbështetet në evidencë.